



Trashegimia Natyrore dhe Kulturore e Shqiperise

Cfare quajme Trashegimi Natyrore?

Trashegiminatyrore quhet Teresia e vlerave te mjedisit fizik dhe jetesor te cilen shoqeria e nje vendi te caktuar e ka trasheguar qofte nga nje popull paraardhes ose jo.

Trashegimia Kulturore Shqiptare

```
graph TD; A[Trashegimia Kulturore Shqiptare] --> B[Historike]; A --> C[Vlera Jomateriale]; B --- B_list[• Historike  
• Arkitekturore  
• Arkeologjike  
• Fetare  
• Artistike  
• Mjedisore]; C --- C_list[• Gjuha  
• Zakonet  
• Traditat  
• Vallet  
• Kenget etj];
```

- Historike
- Arkitekturore
- Arkeologjike
- Fetare
- Artistike
- Mjedisore

Vlera Jomateriale


- Gjuha
- Zakonet
- Traditat
- Vallet
- Kenget etj

Monumentet Arkitekurore


Ne territorin e Republikës së Shqipërisë ndodhen një sërë monumentesh me vlera arkitekurore të konsiderueshme të cilat datojnë heret dhe madje deshmojnë nga vlera historike për ekzistencën e popullit tonë. Megjithatë në slided në vazhdim do të shihni vetëm disa prej tyre.

Amfiteatri I Butrintit

Teatri në Butrint është ndërtuar i mbështetur në shpatin e kodrës së Akropolit me pamje nga Kanali i Vivarit. Shfrytëzimi i shpatit natyror ofronte një zgjidhje praktike për vendin ku uleshin, dhe ky ishte një tipar i rëndomtë i teatrove antike greke. Teatri më i hershëm duket të ketë qenë shumë i vogël. U zmadhua në shek. 3 para Kr. dhe hapësira e ulëseve (cavea) u zgjerua deri te ndërtesa e thesarit. Ndenjëset ishin të organizuara sipas një hierarkie, me ulëset më të afërta me skenën të rezervuara për njerëzit më autoritarë. Rreshti i parë i ulëseve kishte përpara vend për t'i pushuar këmbët dhe ishte i dekoruar me këmbë të bukura të luanit, kurse pas ulëseve kishte blloqe të rrafshta.



Perfomancat nuk duhet të kenë ndodhur në zonën e sheshtë rrethore (orchestra) por në skenën e ngritur (scaenae frons). Skena e ndërtesës është rimodeluar katërçipërisht gjatë periudhës romake, duke e bërë atë më të thellë dhe së paku dy kate më të lartë. Dy hapjet e mëdha që duken sot ishin hyrjet dhe daljet e performantëve, kurse këndet duhet të kenë pasur një mori statujash. Gjithashtu dhe auditori ishte më i zgjeruar në periudhën romake pasi i duhej të akomodonte popullatën në rritje të qytetit. Hyrjet në teatër nga të dy anët e skenës ishin të mbuluara me qemer. Është ende e kontestuar koha se kur doli teatri jashtë përdorimit, por ka të ngjarë që kjo të ketë ndodhur në antikitetin e vonë, ashtu siç ndodhi kudo në botën mesdhetare. Sigurisht që shkatërrimi i strukturave dhe ripërdorimi i tyre për qëllime të tjera duhet të ketë qenë një proces i stërgjatë



Pazari I Krujes

Pazari i Krujës, i cili njihet edhe si një Pazar karakteristik, por edhe zonë turistike është i vendosur në të dy anët e një korridori të gjatë e të shtruar me kalldrëm, por ai realisht ka qenë shumë më i gjatë se sa është sot. Zona Turistike-Pazari i Krujës është cilësuar monument kulture i kategorisë së parë sipas Institutit të Monumenteve të Kulturës së Shqipërisë dhe është një nga destinacionet turistike më të vizituara në vend



MONUMENTET HISTORIKE

Ne territorin e Shqiperise gjenden nje mori Keshtjellash te cilat dallojone qe prej periudhave antike e deri ne mesjete. I vecante eshte fakti se disa prej tyre vazhdojne te banohen edhe sote e kesaj dite. Ne slided qe vijojne do te gjeni te permendura disa prej tyre.

Kalaja e Beratit

Kalaja e Beratit është ngritur në një kodër 187 metra të lartë, në të majtë të grykës së lumit Osum. Fillimisht, një vendbanim protourban, në shekullin e VII-V p.e.s, si një pikë strategjike e rëndësishme, ajo u shndërrua në qytet kështjellë me mure që arrinin në gjatësi deri në 1.400 metra dhe me një sipërfaqe prej 10 ha. Burimet historike deshmojnë se prej këtij viti kalaja e Beratit ka qenë objekt i sulmeve të ndryshme. Në dokumenta të ndryshme historike të kohës gjenden një sërë emrash. Me emrin e lashtë Antipatrea përmendet në vitin 216 p.e.s.. Nga romakët u quajt edhe Albanorum oppidium (fortesa e Arberve). Një nga monumentet më të bukura, më të mëdha dhe më të rëndësishëm të historisë dhe kulturës shqiptare është padyshim kalaja e Beratit. Me formën e saj të spikatur në trajtë trekëndëshi ajo ngrihet mbi një kodër të lartë 187 m, e cila ndodhet në bregun e djathtë të lumit Osum, duke dominuar luginën e tij (Hëna Spahiu, Qyteti Iliro-Arbëror i Beratit. Tiranë 1990, fq. 9-11). Në të kaluarën siguria e kësaj kështjelle ka qenë maksimale, sepse projektuesit e saj e ndërtuan pikërisht në këtë kodër ku ana jugore bie thikë mbi Osum, anët lindore dhe perëndimore kanë pjerrësi të madhe ndërsa në anën veriore kodra ulet ëmbël drejt qafës së Biftës, duke siguruar komunikimin. Muret kanë një perimetër prej 1400 m brinja lindore e këtij trekëndëshi është e gjatë 620 m ndërsa dy tjerat janë të barabarta dhe janë të gjata 410 m (Berati, Historia dhe arkitektura Tiranë 1988, fq. 34

NDRYSHË NGA KËSHTJELLAT E TJERA KALAJA E BERATIT KA QENË E PAJISUR ME 24 KULLA TË CILAT EMËRTOHEN SOT ME EMRIN TURK TABJE SË BASHKU ME MURET ATO I PËRKASIN PERIUDHAVE TË NDRYSHME TË NDËRTIMIT QË NISIN QYSH NGA SHEKULLI IV PK DHE PËRFUNDOJNË GJATË KOHËS SË SUNDIMIT TË ALI PASHË TEPELENËS (1813-1821). BRENDA SIPËRFAQES PREJ 9.6 HA TË KALASË NDODHEN DISA KISHA, NJË PJESË E TË CILAVE RRËNOJË, SARAJET TURKE, RRËNOJAT E DY XHAMIVE, STERNAT E UJIT TË QUAJTURA SARANXHA, SHESHI I SALLABANDËS, SHESHI I QUAJTUR FUSHA E MADHE ETJ. NDËRKOHË QË PJESËN MË TË MADHE TË KËTIJ OBORRIT TË BRENDSHËM E ZËNË NJË SËRË RRUGICASH, KOPSHTESH, BACESH DHE SHTËPI BANIMI TË CILAT PËRBËJNË LAGJEN E QUAJTUR KALA. GJITHSEJ KY MONUMENT KA KATËR PORTA KOMUNIKIMI. NJËRA PREJ TYRE DHE PIKËRISHT AJO QË PARAQET MË SHUMË INTERES PËR SHKAK TË ELEMENTEVE PËRBËRËS TË SAJ ËSHTË ATO E ANËS JUGLINDORE. PASI KALON NË TË FUTESH NË NJË OBORR TË FORTIFIKUAR, KU PËRPARA TË DEL NJË PORTË E DYTË PIKËRISHT NË MURIN BALLOR TË SAJ, NË ANËN E DJATHTË TË NJË HARKU (APOLLON BAÇE, QYTETI I FORTIFIKUAR I BERATIT, MONUMENTET 2, 1971, FQ.43-63), NDODHET NJË MONOGRAM ME TULLA TË KUQE QË I PËRKET NDËRTIMEVE BIZANTINE TË VITIT 1204. I NDËRTUAR ASHTU SI I GJITHË KOMPLEKSI MBROJTËS NGA DESPOTI I EPIRIT MIHAL I PORTA ME MONOGRAMIN NË FORMË KRYQI ME INICIALET M.K. EDHE SOT RUAN PO KËTË EMËR “PORTA E MIHAL KOMNENIT”.



Kalaja e Rozafes

Padyshim qe nuk mund te lihet pa permendur kalaja e Rozafes.

Kalaja e Shkodrës që mban emrin Rozafa është një monument mijëvjeçar i ngritur mbi një kodër shkëmbore në hyrje të qytetit të Shkodrës, në jug-lindje të tij. Qëndron mbi një kodër shkëmbore 130 metra mbi nivelin e detit, e rrethuar nga lumi Buna e Drin, me një sipërfaqe prej gati 9 hektarësh. Kalaja përbën një simbol të qytetit, e pranishme ndër piktura, gdhendje, kartolina, stema etj.



Legjenda e Kalase se Rozafatit

Sipas legjendës së dhimbshme, ndërtimi i Kalasë ishte i mallkuar prej perëndive të cilat shembnin çdo natë ndërtimin e çdo dite. Për të lejuar qëndrimin e mureve të kalasë, ato kërkuan një sakrificë e cila padrejtësisht u vendos të ishte Rozafa, nusja më e vogël e shtëpisë. Përpara se të vetësakrifikohej e të murosej e gjallë, Rozafa tregoi heroizmin dhe altruizmin e saj duke kërkuar që gjysma e trupit të saj të mbetej jashtë murit, në mënyrë që të ushqente e të kujdesej për foshnjen e saj. Një skulpturë e bukur e figurës së Rozafës e gdhendur brenda murit të saj gjendet në hyrje të kalasë. Ndërsa kalaja përmendet gjatë sundimit të mbretit ilir Gent, emrin Rozafa e hasim së pari gjatë mesjetës.




Monumentet arkeologjike


Qyteti Antik I Durrësit



Qyteti I lashte I Antigonesë



Kultura e Komanit



Liqenet e Lures



Mali I Tomorrit



Valbona



Thethi



PUNOI: ANDRI CEPELE

